



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 27.07.2024

Nr. 2220

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

**PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIK TË IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS
4 GUSHT 2024**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË
FUQI.**

Neni 14, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar përgjegjësinë e Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përcaktimin e zbatueshmërisë dhe drejton punën për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve.

Ai bashkushtron me të drejta të barabarta me Komisionerin, kompetencat për përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve.

Neni 20, pika 1, shkronja “ë”, i Kodit Zgjedhor, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre.

Neni 22 pika 4, i Kodit Zgjedhor ka parashikuar Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje. Sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që KQZ-ja vendos të përdoren në zgjedhje duhet të synojnë, në radhë të parë, identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin paszgjedhor të tyre, votimin me dhe nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe numërimin nga pajisjet të votave të hedhura, si dhe të jenë të aplikueshme së paku për pesë procese zgjedhore të njëpasnjëshme.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT.

Në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në këtë projektvendim parashikohet përdorimi i pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) në të gjitha qendrat e votimit, për të kryer identifikimin elektronik të zgjedhësve në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.

Ngarkohet me përgjegjësi për zbatimin e këtij projektvendimi, Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe NënKomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet administratës së KQZ, i propozojnë Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

Sekretar i Përgjithshëm

(në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: __. __. 2024

Nr:

Ora: __: __

VENDIM
PËR

**PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIK TË IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË
DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të dekretit të Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë” dhe nenit 14, pika 2, nenit 20, pikat 1, shkronja “ë”, dhe nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

- Në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) në të gjithë qendrat e votimit në Bashkinë Himarë.
- Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Kopje: 3

Dritan ÇAKA

Anëtar

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Helga VUKAJ

Anëtar

Kompjuterizoi:

M. Koja _____

A. Lamçe _____

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

M. Çelmeta _____

Data: __. __. 2024 Nr:
Ora:



“Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”